Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/500
Datë: 05.08.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.08.2022 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** institucioni Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT", me dy qendra në adresat: Rruga "Idriz Seferi", në Komunën e Gjilan dhe Rruga "Ukë Bytyqi" në Komunën e Prizrenit, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2022 deri më 31.08.2025, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - **1.1 Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë**, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni në qendrën në Gjilan mund të realizojë procesin e mësimit teorik me nga njëzet e pesë (25) nxënës në tre klasë, ndërsa realizimi i pjesës praktike të ndahen në grupe me nga 6 deri në 8 nxënës për një grup. Institucioni në qendrën në Prizren mund të realizojë procesin e mësimit teorik me nga njëzet e pesë (25) nxënës në katër klasë, ndërsa realizimi i pjesës praktike të ndahet në grupe me nga 6 deri në 8 nxënës për një grup.
   - **1.2 Teknik i Laboratorit Mjekësor**, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni në qendrën në Gjilan mund të realizojë procesin e mësimit teorik me nga njëzet e pesë (25) nxënës në dy klasë, ndërsa realizimi i pjesës praktike të ndahen në grupe me nga 8 deri në 10 nxënës për një grup. Institucioni në qendrën në Prizren mund të realizojë procesin e mësimit teorik me nga njëzet e pesë (25) nxënës në dy klasë, ndërsa realizimi i pjesës praktike të ndahen në grupe me nga 8 deri në 10 nxënës për një grup.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK